



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Point Construction" Sh.P.K. të datës 16.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi dhe montimi i kiosqeve-ritender" me nr. të prokurimit 616-23-4105-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Point Construction" Sh.P.K. e datës 16.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi dhe montimi i kiosqeve-ritender" me nr. të prokurimit 616-23-4105-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Point Construction" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Point Construction" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi dhe montimi i kiosqeve-ritender" me nr. të prokurimit 616-23-4105-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Fillimisht na është kërkuar sqarime në lidhje me përvojën e stafit dhe ne i kemi ofruar sqarimet dhe dëshmitë e të cilat janë marrë parasysh nga ju. Sa i përket arsyes së eliminimit të se në planin dinamik nuk është cekur data e fillimit dhe përfundimit të pozicionit, ju sqarojmë se plani dinamik i ofruar nga ne është i përpiluar në detaje. Sa i përket datave të fillimit dhe përfundimit të punimeve, ju sqarojmë se asnjëri nga operatorët ekonomik nuk ka mundur të di saktë datën e fillimit të punimeve sepse fillimisht nuk dihet se sa zgjat procesi i vlerësimit të ofertave, nuk dihet se a ka ankesa dhe nuk dihet se kur nënshkruhet kontrata, prandaj nuk mund të vendoset datë e saktë e fillimit dhe përfundimit të punimeve”*.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimet e parashtruesit:** me datë 04.05.2023 Autoriteti Kontraktues kishte publikuar B54 Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara përmes të cilit në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional është përcaktuar si në vijim *“Po ashtu OE duhet të dorëzoj Planin Dinamik i Detajuar per secilin pozicion te përshkruar ne Panamasë. Per secilin pozicion te përshkruar ne Panamasë duhet te shënohet data e fillimit dhe data e përfundimit te pozicionit dhe kohëzgjatja, numrin e ditëve te nevojshme per përfundimin e pozicionit. Gjithë ashtu se paku ne rreshtin e fundit te shënohet te dhënat per numrin e përgjithshëm te punëtoreve dhe stafit te OE te angazhuar ne punishte ne ditën apo datën e caktuar ne “Planin Dinamik”. Ne “Planin Dinamik” te shënohen ditët e pushimit (ditët e diela) si dite e festave sipas kalendarit te Republikës se Kosovës. Planin dinamik te detajuar”*.

Në njoftimin mbi vendimin e AK parashtruesi është njoftuar se është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm me arsyetimin si në vijim: *“Gjatë procesit të vlerësimit i është kërkuar dëshmi të përvojës së punës për stafin e prezentuar, OE ka kthyer përgjigje në kohë për përvojën e stafit. Në planin dinamik i ka cekur numrin e ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit, të dhënat për numrin e përgjithshëm të punëtorëve dhe stafit të OE të angazhuar në punishte në ditën apo datën e caktuar në Planin Dinamik, ndërsa nuk ka cekur datën e fillimit dhe përfundimit të pozicionit, si dhe mungesën e përshkrimit me fjalë të ditës së diel. Dy anëtarët e komisionit nga njësia e kërkesës e konsiderojnë si mangësi në përpilim të planit dinamik duke e bërë të pavlefshme një plan të tillë. Si të tillë e konsiderojmë ofertën e papërgjegjshme”*.

Nga analizimi i pretendimit të parashtruesit rezulton se nuk është fare kontestues fakti që parashtruesi nuk e ka plotësuar planin dinamik në formë siç është kërkuar nga DT. Kjo për arsye se parashtruesi e pranon që nuk i ka plotësuar në formën e duhur rubrikat përkatëse të planit dinamik sikurse që i ka evidentuar komisioni vlerësues. Megjithatë parashtruesi pretendon se kjo mënyrë e plotësimit të planit dinamik është në përputhje me kërkesat e DT. Në anën tjetër këtë mendim nuk e ndan edhe komisioni i vlerësimit.

Nga raporti i vlerësimit të tenderëve si dhe nga njoftimi mbi vendimin e AK respektivisht letrës standarde për tenderuesin e eliminuar është gjetur se dy (2) nga tre (3) anëtarët e komisionit vlerësues kanë evidentuar konstatimin se parashtruesi nuk e ka plotësuar tërësisht planin dinamik me të dhënat siç është kërkuar me dosjen e tenderit. Pikërisht për këtë arsye parashtruesi është eliminuar edhe si tenderues i papërgjegjshëm. Duke marrë parasysh këto gjetje të komisionit vlerësues në raportin e vlerësimit dhe në njoftimin mbi vendimin, zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin gjetjeve dhe bindjes së lirë profesionale të komisionit vlerësues.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 20.06.2023**

**Visar SHEHU**  
  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.